



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDËTËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 1299 prot.

Tiranë, më 08/03/2020

URDHËR

Nr. 132 datë 08.03.2020

PËR

MBYLLJEN E AKTIVITETEVE PUBLIKE DHE JOPUBLIKE DHE ANULLIMIN E GRUMBULLIMEVE MASIVE NË VENDE TË MBYLLURA APO TË HAPURA

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërmat "b" dhe "c", të Ligjit nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", Vendimit të datës 8.03.2020 të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirusi i ri" si edhe udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e aktiviteteve publike dhe jopublike të tilla si aktivitete sportive, aktivitete kulturore dhe konferenca, deri në datën 3 prill 2020.
2. Anullimin e grumbullimeve masive në vende të mbyllura apo të hapura të tilla si koncerte, tubime dhe dëgjesa publike, deri në datën 3 prill 2020.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Instituti i Shëndetit Publik dhe të gjithë strukturat përgjegjëse për organizimin e veprimtarive të përcaktuara në pikën 1 dhe 2 të këtij urdhëri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

